

Portali e-Professor Informatë

Çka ofron portali e-professor

Portali e-professor është një prej shërbimeve të digjitalizuar të Kolegjit AAB që i kontribuon komunikimit shumë më të shpejtë dhe më të saktë në mes ligjëruesve dhe studentëve, studentëve mes vete, institucionit me dy palët etj.

Ky shërbim elektronik përdoruesit (profesorit) ia mundëson:

- Publikimin e resurseve:
 - Ligjëratë
 - Ushtrime
 - Literaturë
 - Detyrë
 - Kuize
 - Syllabuset
 - Url-adresatj.
- Publikimet e tjera si:
 - Blog(diskutim)
 - Lajmërimë
 - Mesazhe
- Ruajtjen e dokumenteve private
- Monitorim
- Statistikat e publikimeve etj

Si të keni qasje në e-professor

Për të pasur qasje në portalin e-professor ju nevojitet:

- **Emri i përdoruesit** (përdoruesi) dhe
- **Fjalëkalimi** (passwordi).

Shërbimi ynë i IT-së, është përkujdesur që të krijojë llogari personale për secilin përdorues. Llogarinë tuaj do e pranoni në formë elektronike (përmes email adresës suaj) ose në dekanatet përkatëse. Në rastin kur ju keni harruar apo nuk jeni pajisur fare me të dhënat e llogarisë tuaj atëherë mund të drejtoheni te personi përgjegjës i fakultetit tuaj ose direkt te përgjegjësit për probleme teknike të portalit.

Përgjegjësit për probleme teknike janë:

Valdete Daku: valdete.daku@aab-edu.net

Arlind Llullaku: arlind.llullaku@aab-edu.net

Përgjegjësit e fakulteteve janë:

F. Ekonomik:	Shaip BYTYQI	shaip.bytyqi@universitetiaab.com
F. Juridik:	Ganimete Ismajli	ganimete.ismajli@universitetiaab.com
F. Gjuhës Angleze:	Aida Alla	aida.alla@universitetiaab.com
F. Shkencave Kompjuterike:	Valdete DAKU	valdete.daku@aab-edu.net
F. Psikologjisë:	Mimoza Kamberi	mimoza.kamberi@universitetiaab.com
F. Kulturës Fizike:	Besim GASHI	besim.gashi@universitetiaab.com
F. Shkencave Sociale:	Saranda SHATRI	saranda.shatri@universitetiaab.com
F. Administratës Publike:	Mentor LECAJ	mentor.lecaj@universitetiaab.com
F. Komunikimit Masiv:	Mimoza DOKO	mimoza.doko@universitetiaab.com

Rekomandohet, për shkaqe sigurie, ndryshimi i fjalëkalimit pasi të jeni qasur në llogarinë tuaj.

Menytë e portalit e-profesor

Dokumentet e mia – ky opsion përdoruesit i jep mundësi të ruajë dokumentet e veta. Në asnjërën nga dokumentet që ruhen në këtë opsion nuk kanë qasje as **studentët dhe askush tjetër përveç përdoruesit**.

Komunikimi

- **Blog (Diskutim)** – ky opsion i jep mundësi profesorit të hapë një temë diskutimi me studentët e tij. Nëse profesori hap diskutimin atëherë në këtë diskutim kanë qasje dhe mundësi inkuadrimi vetëm studentët e grupit që profesori ligjëron. Çdo përgjigje e dhënë nga studentët dhe profesori është thujse në kohë reale.
- **Lajmërime dhe mesazhe** –ky opsion i jep mundësi profesorit të publikojë ndonjë njoftim për të cilin nuk ka nevojë për përgjigje nga studentët.

Publikime

- **Ligjëratë, ushtrime, literaturë, rezultate etj** –mundëson publikimi e literaturës së nevojshme e klasifikuar në opsionet e lartcekura sipas llojit të literaturës.
- **Detyra** – në këtë opsion publikohen detyrat për studentë. Studenti ka mundësi të marrë detyrën e publikuar nga profesori dhe të kthejë përgjigje. Të njëjtat mundësi i ka edhe profesori, shih përgjigjen e studentit dhe mund t'i kthejë përgjigje me apo pa attach.
- **Syllabus** –këtu duhet të publikohet syllabusi i lëndës nga të gjithë përgjegjësit e lëndës.

Statistikat

Pjesa e statistikave i jep mundësi përgjegjësit të fakultetit të kontrollojë numrin (jo të dhënat e publikuara) e publikimeve të profesorëve të fakultetit të vet. Pra, shih vetëm numrin e publikimeve të çdo profesori (angazhimi) që ka publikuar në lëndën e atij fakulteti ku përgjegjësi është përgjegjës.

Nëse një profesor është i angazhuar në X (fakulteti ekonomik) dhe Y lëndën (fakulteti i muzikës) atëherë përgjegjësi i fakultetit ekonomik sheh numrin e publikimeve vetëm nga lënda **X** kurse përgjegjësi i fakultetit të muzikës sheh numrin e publikimeve vetëm të lëndës **Y**.

Informata shtesë

- **Kush ka qasje në publikimet e profesorëve?** Në publikimet e çdo profesori (përjashto publikimet në opsionin “dokumentet e mia”) kanë qasje vetëm grupi i studentëve të cilët kanë atë lëndë dhe atë profesor si dhe vetë profesori. Askush tjetër nuk ka asnjë qasje në materialet e publikuara nga profesorët.
- **Si përcaktohet grupi i studentëve?** Në fillim të çdo semestri, pasi të jenë përfunduar angazhimet, krijohet dhe insertohet orari i ligjëratave dhe ushtrimeve në sistem. Nëse X-profesori është i angazhuar në lëndën **Informatikë - drejtimi - banka – gjenerata 2015/2016 - grupi i rregullt – grupi I - kampusi Prishtinë**, atëherë qasje në publikimin nga ky angazhim, në mënyrë automatike, kanë vetëm studentët që i plotësojnë të gjitha karakteristikat e lartcekura.
- **A kanë qasje studentët e gjeneratës së kaluar në publikimet e gjeneratës aktuale?** Jo, vetëm në rastet kur studentit bën rikthim në gjeneratën aktuale.
- **Deri në çfarë madhësie mund të jetë file-i (dokumenti) që dua të publikoj?** Mund të publikohet çdo file (dokument) deri **100MB**.
- **A duhet patjetër të publikoj në e-profesor?** **Po**. Studenti që nga fillimi i vitit akademik 2014/2015 mënyrën kryesore të pajisjes me literaturë për lëndët e tij e ka përmes publikimeve që profesorët i bëjnë në e-profesor.
- **Sa vonohet transferimi i materialeve që publikon profesori deri te llogaria e studentit?** Studenti ka qasje në **kohë reale** në çdo publikim që bëhet nga profesori. Pra, menjëherë.
- **Si të veprohet kur studentët ankohen për mos qasje në materialet e publikuara?** Në këto raste i orientoni studentët të na kontaktojnë në email:

Valdete Daku: valdete.daku@aab-edu.net
Arlind Llullaku: arlind.llullaku@aab-edu.net
- **Pse të përdor e-profesor për dërgimin e materialeve te studentët kur mund të përdor email-in?** Meqë e-profesor funksionon në mënyrë shumë më të thjeshtë dhe më të lehtë për këtë proces. Studentët që gjatë semestrit ndryshojnë grup ose kampus, vijnë si transfere etj... nuk kanë nevojë të mundohen të kontaktojnë me të gjithë profesorët e grupeve dhe statuseve të tjera për të marrë literaturën përkatëse me email, meqë përmes e-profesor automatikisht i bllokohet qasja e vjetër dhe i jepet qasja e re me të gjitha publikimet.
- **A mund të publikoj material nga vendet jashtë Kosovës?** **PO**. Qasje në portal ke nga çdo vend ku ke qasje në internet dhe nëse nuk e keni të ndaluar nga ndonjë mjedis (institucion, kompani etj).
- **Çfarë tipi të file-ave mund të publikohet?** Deri më tani janë të lejuara të gjitha tipet e file-ave për të cilat kemi pasur kërkesë. Nëse gjatë publikimit keni ndonjë problem me ndonjë tip të file-it atëherë na shkruani dhe problem do të zgjidhet.

- **Kujt t'i drejtohem i kur kemi ndonjë problem, pyetje, sugjerim, vërejtje, ide?** Personit përgjegjës të fakultetit ose direkt personave përgjegjës të portalit në nivel universitar:

Valdete Daku: valdete.daku@aab-edu.net

Arlind Llullaku: arlind.llullaku@aab-edu.net

- **Nuk kam qenë në asnjë trajnim për përdorimin e portalit?** Nëse keni vështirësi për përdorim të portalit, çdonjëri nga profesorët në kohën që është në AAB mund t'iu drejtojë për ndihmë të përgjegjësi i fakultetit ose të zyra për zhvillim softuerik: AAB – obj I – Kati V.
- **Deri në çfarë periudhe kohore ka qasje një student në materialet e lëndës?** Deri në momentin kur studentin përfundon provimin e asaj lënde.
- **A duhet të kem llogari të ndryshme nëse ligjëroj në më shumë se një fakultet?** Jo. Pa marrë parasysh numrin e fakulteteve në të cilat ligjëroni ju do të përdorni vetëm një llogari.
- **Si dhe ku i shohin studentët materialet e publikuara nga profesorët në e-profesor?** Studentët kanë portalin e tyre (**e-service**) në të cilin, pos tjerash, kanë edhe rubrikën e materialeve. Në këtë pjesë ata kanë qasje të shohin, lexojnë, downloads, kthejnë përgjigje, diskutojnë etj. në materialet (diskutimet e hapura) e publikuara nga profesori i lëndëve që ata kanë.
- **Çka ndodh me materialet e publikuara pas përfundimit të vitit akademik?** Profesori në çdo kohë mund të plotësojë, ndryshojë apo edhe të fshijë materialin e publikuar në e-profesor sepse është e drejtë ekskluzive e profesorit, mirëpo duke pasur parasysh faktin se jo të gjithë studentët i përfundojnë provimet në afatin e parë të rregullt si dhe numrin e madh të studentëve që vijnë si transfer, atëherë është **rekomandim i fuqishëm** që materialet të mos fshihen nga profesori prej portalit e-profesor me që studentët e humbin të drejtën e qasjes në materialet e publikuara pas përfundimit të provimit përkatës.

Rëndësia e përdorimit të portalit e-profesor

Pajisja e studentëve me literaturë (material), për çdo lëndë që ata kanë, është më së e nevojshme dhe shumë esenciale. Digjitalizimi i pothuajse çdo procesi në këtë kohë na obligon që të gjejmë mënyra sa më të mira që çdo proces, qoftë edhe proces mësimor, të bëjmë sa më funksional.

Pas një viti si pilot projekt, përdorimi i portalit e-profesor nga profesorët dhe në anën tjetër përdorimi i portalit e-service nga studentët ka rezultuar shumë i suksesshëm dhe shumë funksional. Janë ulur në masë të madhe **ankesat e studentëve për mos pranimin e materialeve** për arsye të ndryshme. Ky digjitalizim ka mundësuar **pajisje të studentëve me literaturë shumë më shpejtë dhe shumë më lehtë** duke e **liruar edhe stafin administrativ nga kjo përgjegjësi.** Është rritur interaktiviteti në mes studentëve me profesor si dhe studentëve mes vete. **Pajisja në kohë reale me materiale etj. Janë vetëm disa nga shumë të mira që kemi nga përdorimi i këtij portali nga ana e profesorëve.**

THE GOOD TEACHER MAKES THE POOR STUDENT GOOD AND THE GOOD STUDENT SUPERIOR